UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo

UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

UNMIK/REG/2004/45
19 nëntor 2004

RREGULLORE NR. 2004/45

PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 2003/ 13 MBI TRANSFORMIMIN E SË DREJTËS PËR PËRDORIMIN E PRONËS SË PATUNDSHME NË PRONËSI SHOQËRORE

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/ 13 të datës 9 maj 2003 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore,

Duke marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/12 të datës 13 qershor 2002 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit,

Me qëllim të lehtësimit të likuidimit të pronave të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore për të tërhequr investimet në dobi të ekonomisë së Kosovës,

Me anë të kësaj Rregulloreje shpall ndryshimet për nenin 2 dhe 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 si vijon:

Neni1
Ndryshimet

Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje,

A. Neni 2.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 ndryshohet si vijon:

“ 2.1 Në bazë të kufizimeve dhe ndalimeve të përcaktuara në këtë Rregullore, ushtrimi i çfarëdo të drejte mbi përdorimin e pronës së regjistruar në emër të ndërmarrjes në pronësi shoqërore, e cila

(i) i është transferuar një korporate filial të ndërmarrjes në pronësi shoqërore në përputhje me nenin 8 të Rregullores nr. 2002/12 ose
(ii) ka të bëjë me pronat e patundshme që janë të përfshira në likudimin e ndërmarrjes në pronësi shoqërore në përputhje me nenin 9 të Rregullores nr. 2002/12.

do të transformohet në qira pasi të jetë bërë transferi ose likuidimi.
Një qira e tillë do të përfshijë:

(a) të drejtën e zotërimit dhe të përdorimit të pronës së dhënë me qira për çfarëdo qëllimi që nuk ndalohet sipas ligjit në fuqi;

(b) të drejtën e transferimit të lirshëm të pronës nën qira tek palët e treta dhe

(c) të drejtën e vendosjes së hipotekës mbi pronën nën qira e kushtëzuar në dobi të palëve të treta.

B. Nenet 10.1, 10.2 dhe 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 ndryshohen si vijon:

“10.1 Për shkak të statusit të veçantë të të punësuarëve në ndërmarrjet në pronësi shoqërore në relacion me këto ndërmarrje dhe ndikimit që privatizimi do të ketë në këtë status, të punësuarit e tillë kanë të drejtë parësore të përfitojnë një pjesë të të ardhurave nga privatizimi. Kjo pjesë do të jetë 20% e të ardhurave nga shitja e:

(i) aksioneve të një filiali të korporatës së një ndërmarrjeje të privatizuar në përputhje me nenin 8 të Rregullores nr. 2002/12 ose
(ii) pasurisë që i nënshtrohet procesit të likuidimit vullnetar në bazë të nenit 9 të Rregullores nr. 2002/12.

Shuma do të ndahet në dobi të të punësuarve me të drejta legjitime në përputhje me këtë nen.

10.2 Organi përfaqësues i të punësuarve në ndërmarrjen me pronësi shoqërore në fjalë, në bashkëpunim me Federatën e Sindikatave të Pavarura të Kosovës përpilon listën e të punësuarëve me të drejta legjitime për marrjen e pagesave dhe këtë ia paraqet Agjencisë, në pajtim me paragrafin 10.1. Nëse organi që përfaqëson punëtorët nuk ekziston më, Federata e Sindikatave të Pavarura të Kosovës, në bazë të dëshmive të dokumentuara përpilon listën e punëtorëve që gëzojnë këtë të drejtë në baza jodiskriminuese dhe ia paraqet Agjencisë. Agjencia e shqyrton listën dhe bën ndryshimet që konsiderohen të domosdoshme për të siguruar qasje të barabartë për të gjithë të punësuarit në fondet që duhet ndarë.

10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit apo të fillimit të procedurës së likuidimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri vite. Kjo kërkesë nuk i përjashton punëtorët nga paraqitja e ankesës në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6., të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar po të mos kishin qenë të diskriminuar.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 19 nëntor 2004.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqsues Special i Sekretarit të Përgjithshëm